



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2369/2 prot.

Elbasan, me 02.11.2021

VENDIM

Nr. 39 datë 02.11.2021

Për

ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, si studentë të shkëlqyer, studentë me rezultate dhe kërkesave me kritere të tjera,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," i ndryshuar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit "Ad Hoc" për procedurën e përpunimit të të dhënave të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, me program të parë studimi, që përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, si studentë të shkëlqyer, studentë me rezultate (me notë mesatare të ponderuar 9.00-10.00) dhe kërkesave të studentëve me kritere të tjera, të ngrihet komisioni me përbërje si më poshtë:

- Filip Qosja - kryetar
- Fatma Spahiu - anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime studenti online)
- Eglantina Palloshi - anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime studenti online)
- Eda Çela - anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime studenti online)
- Albert Ndreu - anëtare (procedurat ligjore në dokumentacion, sqarime studenti online)
- Klevis Duka - anëtar (pritje kërkesave online, përpunimi i tyre)
- Laureta Bajrami - anëtare (pritje kërkesave online, përpunimi i tyre)
- Daniela Karalliu - anëtare (pritje kërkesave online, përpunimi i tyre)
- Romina Pitja - anëtare (pritje kërkesave online, përpunimi i tyre)
- Fejzie Musta - anëtare (procedurat financiare, hartimi i skedareve)
- Arta Skënderi - anëtare (procedurat financiare, hartim skedare dhe sistemin e pagesave)
- Rovena Zane - anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem)
- Blerina Seitaj - anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem)



- Armida Gjata - anëtare (procedurat financiare, hartim skedare hedhje të dhëna në sistem)
- 2. Komisioni të realizojë pranimin e kërkesës së studentit online, të kryejë verifikimin e nevojshëm në zbatim të akteve të mësipërme për këto procedura.
- 3. Për studentët e shkëlqyer dhe studentët me rezultate, të merren të dhënat e sjella nga QSHA për vitin e parë, në Fakultetet e UE-së për vitet e dyta e të treta dhe të bëhet përpunimi i tyre.
- 4. Materiali i përgatitur nga komisioni të paraqitet nga Administratori i UE-së në Bordin e Administrimit për shqyrtim e miratim rast pas rasti në zbatim të afateve të përcaktuara në VKM-t përkatëse.
- 5. Ngarkohet Administratori dhe Komisioni i mësipërm me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

ARDIAN DURMISHI

